



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.712/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbareme të kreditorit Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Buxhet dhe Financa, të cilën me autorizim e përfaqëson V.Sh., kundër debitorit IPKO Telecommunications LLC, me seli në Prishtinë, rr. “Zija Shemsiu”, nr.34, me të cilin e përfaqëson me autorizim Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.641/22, të datës 14.04.2023, me datë 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.641/22, të datës 14.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.641/22, të datës 14.04.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit IPKO Telecommunications LLC, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaresit Privat Gëzim Gjoshi P.nr.172/2021 të dt. 09.03.2021, në pikën II andaj ka shfuqizuar urdhrin e përmbareme P.nr.172/2021 të dt. 09.03.2021, Përmbaresit Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, në pikën III të dispozitivit ka detyruar kreditorin që debitorit, t’ia paguajë të gjitha shpenzimet e shkaktuara në procedurë të përmbaremit dhe në pikën IV ka përfunduar procedura përmbareme KPP.nr.641/2022 dhe abrogohet të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike- përmbareme.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të detyrohet kreditori që debitorit t’ia kompensojë shpenzimet procedurale, ndërkaq prapësimin e debitorit ta refuzoi në tërësi, apo t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala debitore, duke propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit si i pa bazuar dhe aktvendimi KPPP.nr.641/22, të datës 14.04.2023 të vërtetohet dhe të detyrohet kreditori që në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë të paguaj shumën prej 650.00 euro .

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit IPKO Telecommunications LLC, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktin nga librat afarist- Kartelën financiare me Nr. 102120/30227493 dhe Nr. 102121/30227494, në emër të obligimit tatimor komunal për periudhën nga viti 2009 deri me vitin 2021, në lartësi prej 254,877.00 euro, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.172/2021 të dt. 09.03.2021, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se kemi të bëjmë me borxh të vjetërsuar paso që kreditori ka kërkuar përmbartimin e një detyrimi i cili është llogaritur në baza vjetore që nga viti 2009, ndërkaq propozimin për përmbartim e ka paraqitur në viri 2021. Gjithashtu kemi të bëjmë me dispozita ligjore nga nenin 22 par.6 të Ligjit për Komunikime Elektronike, sipas të cilit përjashtohet ngarkesa me taksën e pronës së paluajtshme për subjektin të cilën shtrijnë infrastrukturën e rrjeteve të komunikimit për qëllime të interesit të përgjithshëm publik.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbartimi duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim te nenit 71 te LPP qe te aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.641/22, të datës 14.04.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit IPKO Telecommunications LLC, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi P.nr.172/2021 të dt. 09.03.2021, në pikën II andaj ka shfuqizuar urdhrin e përmbartimor P.nr.172/2021 të dt. 09.03.2021, Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, në pikën III të dispozitivit ka detyruar kreditorin që debitorit, t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e shkaktuara në procedurë të përmbartimit dhe në pikën IV ka përfunduar procedura përmbartimore KPP.nr.641/2022 dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike- përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim se në rastin konkret nga ekstrakti i verifikuar nga kartela financiare e klientit në aspektin formal, konform nenit 22, 37 dhe 38 lidhur me nenin 29 par. 1.2 të LPP-së qëndron si dokument i besueshëm mbi bazën e të cilit mund të iniciohet procedura përmbartimore. Mirëpo, për nga përmbajtja, gjykata konstaton se Kreditori ka kërkuar përmbartimin e një detyrimi i cili nuk ka mbështetje ligjore, konform vendimeve pasuese sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI 189/20 date 11.11.2021. Konkretisht, në pasim të këtij vendimi, sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit me Aktgjykimin A.A.r.30/2022 datë 18.01.2022, Komuna e Gjakovës

nuk ka tagër që të ngarkojë subjektin / Debitorin Ipko Telecommunications LLC me tatim në pronë për shkak të mbizotërimit zbatues të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike i cili trajtohet si Lex Specialis kundrejt Ligjit për tatimin në pronë. Nga ky përfundim, konform nenit 71 par. 1.1 dhe par. 1.10 i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), Gjykata konstaton se bie titulli përmbartimor gjegjësisht nuk mund të aplikohet ngarkesa me detyrim tatimor ndaj debitorit, për shkak se kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me statut të kufizimeve. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.172/2021 të dt. 09.03.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, para.1 dhe 2 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku paragrafi 1. Përcakton se, propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit, ndërsa paragrafi 2. Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Gjithashtu në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktin nga librat afarist Nr. DPR 90025119, ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm sipas LPP-së. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin-ekstraktin e cila gjithashtu paraqet dokument të besueshëm. Mirëpo, për nga përmbajtja, gjykata konstaton se Kreditori ka kërkuar përmbartimin e një detyrimi i cili nuk ka mbështetje ligjore, konform vendimeve pasuese sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI 189/20 date 11.11.2021. Konkretisht, në pasim të këtij vendimi, sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit me Aktgjykimin A.A.r.30/2022 datë 18.01.2022, Komuna e Gjakovës nuk ka tagër që të ngarkojë subjektin / Debitorin Ipko Telecommunications LLC me tatim në pronë për shkak të mbizotërimit zbatues të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike i cili trajtohet si Lex Specialis kundrejt Ligjit për tatimin në pronë dhe duk u bazuar me neni 71 par. 1.1 dhe par. 1.10 i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), konstatohet se bie titulli përmbartimor gjegjësisht nuk mund të aplikohet ngarkesa me detyrim tatimor ndaj debitorit, për shkak se kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me statut të kufizimeve, prandaj edhe gjykata e shkallës së dytë, pajtohet në tërësi me qëndrimin

juridik te gjykatës se shkallës së parëse ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, pasi që ky dokument nuk ka mbështetje ligjore.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbarimit të detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.712/2023, me datë 08.05.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v